


|      |                |  |  |
|------|----------------|--|--|
| Dok. | AMED-EMS-G-001 | <b>Udhezimi mbi Mjedisin,<br/>Shendetin dhe Sigurine</b> |  |
| Rev. | 07             |  |  |
| Datë | 01/07/2024     |  | <b>I Brendshëm/I Jashtëm</b>   |

**Udhezimi mbi Mjedisin, Shendetin dhe Sigurine (UMSHS) per Kontraktuesit dhe Nenktraktuesit e TIA-s ne Aeroportin Nderkombetar te Tiranës ("TIA")**

**1. Mjedis Natyror**

Ekosistemet e TIA-s jane pjese e mjedisit rrethues dhe kane efekt ripertes per ekosistemet natyrale nga ndertimet dhe instalimet. Ne menyre qe te ruhet ekuilibri i duhur ne ekosistemet, bimet dhe kafshet duhet te mbrohen, si dhe aktivitetet qe mund te shkaktojne efekte negative ne natyre duhet te shmangen.

**2. Cilesia e Ujit**

Per perdorimin e detegjenteve/pastruesve per makinat, autobuzet dhe avionet duhet te sigurohen produkte ne respekt ndaj mjedisit, per arsye se perdorimi i ketyre produkteve mund te shkaktojne demtime thelbesore te mjedisit.

**3. Masat qe duhet te merren ne rastin e derdhjeve te rrezikshme te mundshme**

Derdhjet e rrezikshme ne ambientet e TIA-s perbejne nje shqetesim te madh. Nese kontraktuesve te TIA-s u ndodh nje derdhje, ajo duhet te izolohet menjehere perpara se te hyje ne sistemet shkarkuese te TIA-s. Derdhjet e izoluara duhet te eliminohen biologjikisht me perdorimin e kimikateve te miratuara. Nese kontraktuesit e TIA-s nuk mund te izolojne dhe te pastrojne derdhjet, duhet te kontaktohet menjehere Departamenti i Menaxhimit te Aseteve dhe Mjedisit (AMED) ose Menaxheri i Operimit ne Detyre (ODM)/Ekipi i Zjarrefikesve. Kontraktuesit e TIA-s jane te lutur te ruajne TIA-n "Te paprekur nga derdhjet dhe papasterite".

**4. Cilesia e Ajrit**

Kontraktuesit e TIA-s duhet te zbatojne programe te tilla qe te shmangin ndotjen e ajrit. Per arritjen e ketij objekti, kontraktuesit e TIA-s duhet te sigurojne:

- Testimin e zakonshem te shkarkuesve te automjeteve
- Perputhshmerine me te gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe/ose standardet nderkombetare te zbatueshme
- Te fikin motoret kur nuk jane ne perdorim.

**5. Menaxhimi i mbetjeve**

Te gjitha llojet e mbetjeve duhet te depozitohen ne pikat qendrore te grumbullimit te mbetjeve te TIA-s sic eshte percaktuar dhe i'u eshte bere e ditur te gjithe Qiramarresve dhe Kontraktuesve te TIA-s ne menyre qe te mblidhen dhe te largohen nga kontraktuesi i certifikuar i TIA-s per menaxhimin e mbetjeve.

**6. Menaxhimi i Zhurmave**

Kontraktuesit e TIA-s duhet te minimizojne aktivitetet qe shkaktojne zhurme shqetesuese per perdoruesit e TIA-s, te punesuarit dhe komunitetin rrethues. Do te perbente nje avantazh per kontraktuesit e TIA-s nese:

- Minimizojne perdorimin e Njesive Ndhimese te Energjise
- Kryejne testimin e zakonshem te automjeteve dhe sigurojne Certifikaten Shqiptare.

**7. Menaxhimi i Burimeve**

Menaxhimi i burimeve eshte nje aspekt me rendesi i operimeve te TIA-s. Kontraktuesit e TIA-s mund te kontribuojne ne permiresimin e mjedisit kur ata:

- Kontrollujne konsumin e energjise

|      |                |  |  |
|------|----------------|--|--|
| Dok. | AMED-EMS-G-001 | <b>Udhezimi mbi Mjedisin,<br/>Shendetin dhe Sigurine</b> |  |
| Rev. | 07             |  | <b>I Brendshëm/I Jashtëm</b>   |
| Datë | 01/07/2024     |  |  |

- Perdorin burime te arsyeshme, si uji, karburanti dhe energjie
- Promovojne perdorimin e pajisjeve me eficience energjie
- Sigurojne mirembajtjen e duhur te pajisjeve
- Stimulojne perdorimin e karburantit ne respekt ndaj mjedisit dhe burimet alternative te energjise.

#### **8. Mbeshtetja qe i siguron TIA Kontraktuesve te tij per aktivitetin mjedisor**

Departamenti i Menaxhimit te Aseteve dhe Mjedisit te TIA-s eshte i gatshem te mbeshtese aktivitetet mjedisore te kontraktuesve te TIA-s nepermjet:

- Keshillave/Udhezimeve
- Trajnimeve
- Inspektimeve/Auditimeve
- Aktiviteteve promocionale (Buletini Mjedisor dhe Social i TIA-s).

#### **9. Hapat qe duhet te ndermarrin Kontraktuesit e TIA-s per te siguruar nje Menaxhim te Duhur te Mbetjeve te Rrezikshme**

- Te caktojne nje perfaqesues qe do te drejtoje ceshtjet e mbetjeve te rrezikshme
- Te grumbullojne dhe te depozitojne mbetjet e rrezikshme ne vendin e gjenerimit dhe perdorimit te konteinerave te etiketuar. Vendi i grumbullimit te mbetjeve duhet te jete i mbrojtur nga shiu dhe drita e diellit, duhet te kete sinjalistiken e perkatese dhe te merren masa mbrojtese dytesore. Personeli i Departamentit te Menaxhimit te Aseteve dhe Mjedisit do te kontrolloje ne menyre te rregullt keto zona.
- Te zhvilloje aktivitetet e veta ne nje zone te ajrosur mire dhe funksionale
- Te perdore pajisjet e duhura mbrojtese per mbrojtjen e syve, fytyres, lekures dhe te frymemarrjes se punonjesve te tyre
- Te perdore masa mbrojtese dytesore per te patur nen kontroll perhapjen e ndonje derdhjeje te mundshme
- Te pastrojne derdhjet duke perdorur materialet e duhura dhe kimikate. Nese ka derdhje te hidrokarbureve ne natyre, pastrimi biologjik duhet te kryhet nepermjet kimikateve te miratuara
- Te vleresojne, te paketojne dhe te etiketojne ne menyre korrekte mbetjet e rrezikshme. Kjo do te ndihmoje ne mbrojtjen e asaj pjese te personelit qe kujdeset per mbetjet
- Te pergatisin Flete te Dhenash per Materialet e Sigurise (FDHMS) ne dispozicion te te gjithë personelit te kompanise per cdo material te rrezikshem, duke perfshire ketu materialet e mbetjet me te cilat ata jane te detyruar te punojne. Prodhuesi i substancave te rrezikshme eshte i detyruar me ligj te pajise substancen me FDHMS ne momentin e blerjes
- Te rrisin ne maksimum perdorimin, ose shkembimin e informacionit ndermjet Kontraktuesve te tjere te TIA-s qe perdorin te njejtin produkt ose sherbim
- Te transportojne mbetjet e rrezikshme nepermjet Kontraktuesve te TIA-s ne vendgrumbullimin kryesor te TIA-s.

#### **10. Fusha e Zbatimit e MSHS**

Te gjithë Kontraktuesit e TIA-s do te zbatojne UMSHS per aq sa dispozitat e ndryshme te UMSHS jane te lidhura me aktivitetin e tyre te vecante ne ambientet e TIA-s.

|      |                |  |  |
|------|----------------|--|--|
| Dok. | AMED-EMS-G-001 | <b>Udhezimi mbi Mjedisin,<br/>Shendetin dhe Sigurine</b> |  |
| Rev. | 07             |  |  |
| Datë | 01/07/2024     |  | I Brendshëm/I Jashtëm  |

## 11. Politikat e Mjedisit, Energjisë dhe Karbonit

Aeroporti Nderkombetar i Tiranes SHPK azhuron ne menyre periodike Politiken per Mjedisin dhe Politiken per Energjine dhe Karbonin. Keto Politika jane te disponueshme ne Governing Document Database (nje sistem kompjuterik i rrjetit lokal per menaxhimin e te gjithë dokumentacionit te TIA-s ne adresen: <http://logicaldoc:8081/>).

Stafi dhe te gjithë kontraktoret e TIA-s njoftohen ne lidhje me çdo përditesim të politikave te mesiperme.

Nje kopje e firmosur e ketij udhezimi do te publikohet ne faqen zyrtare te internetit te TIA-s.

Tirana International Airport, 1 Korrik 2024

Marsida Pallko  
Administratore e TIA-s



Piervittorio Farabbi  
Menaxher Përgjegjës i TIA-s dhe  
Administrator / COO

